



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA ELBASAN**

Elbasan më \_\_\_\_\_,\_\_\_\_\_,2024

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMINE SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**PROÇES-VERBAL PËR HARTIMIN E KRITEREVE**

**OBJEKTI I PROKURIMIT:** "Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare "Fadil Gurmani", me fond limit 69,459,305 (gjashtëdhjetë e nëntëmilion e katërqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e treqind e pesë) lekë pa t.v.sh.

- **KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Kodi CPV: 45210000-2 - Punime ndërtimi**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", autoriteti/enti kontraktor, Bashkia Elbasan, ka hartuar proces verbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT**

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;

- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi;
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

### **Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.**

**Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme përvërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.**

Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Kriteret e përgjithshme përmbajne listën e dokumentacionit, ligjor dhe administrativ, të kandidatëve/ofertuesve, që duhet të plotësojnë për të marrë pjesë në procesin e prokurimit, në përputhje me nenin 76 dhe 77 të LPP-së, nr.162 date 23.12.2020 “Per prokurimin Publik”.

Kriteret e përgjithshme për pranimin e operatorëve pjesëmarrës janë të pandryshueshme dhe janë vënë të njëjta me Dokumentet Standarde të Tenderit sipas Vendimit Nr. 02 Datë 09.06.2021 te miratuara nga APP.

## **KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:**

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Kriteri (1- a) është vendosur në bazë të nenit 83 të LPP dhe nenit 30 pika 1 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Kriteri (1-b) bazohet në nenet 76, 77 dhe 82 të LPP si dhe nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

**2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:** Sipas Shtojcës 7.

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1.**Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022 dhe 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit që prokurohet.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

**2.2.2** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022 dhe 2023 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve në përputhje me Ligjin nr.10091,date 05.03.2009 "Per auditimin

ligjor,organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është vendosur referuar nenit 43, pika 4 te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe bazuar në Nenin 77 pika 3, e LPP nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe Ligjin nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c. Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

**2.2.3** Operatori ekonomik duhet të paraqese një vërtetim që ka paguar **taksat dhe tarifat vendore për vitin 2024 (këstet e maturuara)** për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit (sipas QKB), sipas afateve të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore.

Gjithashtu nje deklarate nga administratori i shoqerise mbi kontratat publike dhe private me te cilat eshte angazhuar shoqeria gjate vitit 2024 sipas formatit te meposhtem:

Nr	Emertimi i kontrates	Vendi i zbatimit te kontrares (Bashkia)
1		
2		

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë vërtetim për taksat dhe tarifat vendore).

**Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton pagimin e taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.**

**Argumentimi:**Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 76, pika 2 të LPP si dhe në ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c. Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar qe operatorët ekonomikë nuk kane pagesa te pashlyera të taksave dhe tarifave vendore.

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

### **2.3.1** Përvojë e suksesshme në ekzekutimin e të paktën:

**a-**punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

**b)**punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

**-Për të vërtetuar përvojen e mëparshme duhet të paraqiten:**

**-Nëse kontrata është realizuar me institucione shtetërore:** Formulari i vlerësimit (sipas shtojcës 9) i shoqëruar me: -Kontratë punimesh; -Situacion përfundimtar; -Akt-kolaudimi; -Procesverbal për marrje në dorëzim të punimeve të kryera.

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontraten e bashkimit të operatorëve ekonomikë si dhe preventivin e ndarjes së punimeve të marra përsipër nga secili operator ekonomik të deklaruara në fazën e tenderimit.

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe Miratimi zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

**-Nëse kontrata është realizuar me subjekte private:** Formulari i vlerësimit i shoqëruar me: - Kontratë punimesh, -Situacionin përfundimtar, -Akt-kolaudimin, -Çertifikatën e marrjes në dorëzim,- Faturat tatimore për Situacionin përfundimtar.

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Investitorit.

**Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura për përvojen e suksesshme e bën ofertën të kualifikueshme.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo me te vogël se dyfishi i vlerës limit të objektit të prokurimit për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

**2.3.2 Liçensa profesionale e shoqërise për realizimin e punimeve, objekt i kontratës:**

**PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI:**

- **N.P - 1 A** Punime gërmimi në tokë
- **N.P - 3 B** Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada
- **N.P - 4 A** Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale
- **N.P - 7 A** Ujësjiellës, gazsjiellës, vajsjiellës, vepra kullimi e vaditje.
- **N.P – 11 A** Ndërtime për n/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.
- **N.P – 12 A** Punime të inxhinierise te mjedisit

**PUNIME SPECIALE NDËRTIMI:**

- **N.S - 1 A** Punime për prishjen e ndërtimeve
- **N.S- 2 A** Impiante hidrosanitare kuzhina, lavanteri dhe mirembajtja e tyre
- **N.S - 4 A** Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale

druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtues

- **N.S - 12 A** Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit.
- **N.S - 14 A** Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV.
- **N.S - 18 A** Punime topogjeodezike

***Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës, në plotësimin të licensave profesionale të kerkuara për ekzekutimin e kontratës.***

***Argumentimi:*** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar si dhe në Vendimin e Keshillit të Ministrave nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar me VKM nr 92 .DT 19.02.2014 ku janë të përcaktuara kategoritë përkatëse dhe niveli i klasifikimit për licensat e subjekteve që ushtrojnë veprimtari në fushën e ndërtimit.

*Kategoritë e licensave janë përcaktuar në bazë të zerave të pershkuara në preventivin e projektit.*

*Niveli i Shoqërisë sipas vlerave në lekë të punimeve të kryera për çdo kategori punimi.*

<i>Kategoria e kërkuar</i>	<i>Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës</i>	<i>Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse</i>	<i>Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive</i>	<i>Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse</i>
NP-1	<i>Punime gërmimi në tokë.</i>	<i>Punime gërmimi dhe sipas preventivit: Gërmimi dhe me ekskavator goma 0.25 m<sup>3</sup>, në kanale gjeresi &gt; 2 m, tokë zak, kategoria III, me shk në mjet</i>	A	0-20 milion
NP-3	<i>Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada</i>	<i>Punimet për rikonstruksionin e objektit sipas preventivit</i>	B	21-50 milion
NP-4	<i>Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale</i>	<i>Punimet e shtresave sipas preventivit: Shtrese çakelli mbeturine kave t=15cm, përhapur e ngjeshur me makineri</i>	A	0-20 milion
NP-7	<i>Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje</i>	<i>Punimet për ujesjelles e kanalizim te</i>	A	0-20 milion

		<i>jashtëm sipas preventivit: Puse kont 1.5x1.5x1,5m; F.V tuba betoni Ø 200 mm</i>		
<i>NP-11</i>	<i>Ndërtime për n/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë</i>	<i>Punimet per ndricimin e jashtëm sipas preventivit: F.V.kabllo kontrolli Cu te armuar, ne toke, 4x4 mm<sup>2</sup>; F V shtylla metalike per ndriçim, H=7m, d=160mm</i>	<i>A</i>	<i>0-20 milion</i>
<i>NP-12</i>	<i>Punime të inxhnierise te mjedisit</i>	<i>Punimet sipas preventivit: mbjellje bari ne skarpat</i>	<i>A</i>	<i>0-20 milion</i>
<i>NS-1</i>	<i>Punime per prishjen e ndertimeve</i>	<i>Prishje shtresa betoni, mur tulle, suvatime te jashtme</i>	<i>A</i>	<i>0-20 milion</i>
<i>NS-2</i>	<i>Impiante hidro-sanitare dhe mirembajtja e tyre</i>	<i>Punime per instalimet Hidro-Sanitare sipas preventivit</i>	<i>A</i>	<i>0-20 milion</i>
<i>NS-4</i>	<i>Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to, rifinitura material druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture te natyres teknike ndertuese</i>	<i>Suvatime, lyerje, veshje fasade, punime grafiato etj sipas preventivit</i>	<i>A</i>	<i>0-20 milion</i>
<i>NS-12</i>	<i>Impiante teknologjik, termike dhe kondicionimit.</i>	<i>Punimet per sistemin e ngrohjes sipas preventivit: F.V.Kaldaje me lende djegese Pellet / dru (MLC-BIO 300).</i>	<i>A</i>	<i>0-20 milion</i>
<i>NS-14</i>	<i>Impiante te brendshme elektrike telefoni radiotelefoni TV</i>	<i>Rrjeti i brendshem elektrik dhe telefonise sipas preventivit</i>	<i>A</i>	<i>0-20 milion</i>
<i>NS-18</i>	<i>Punime topogjeodezike</i>	<i>Punimet topogjeodezike sipas projektit</i>	<i>A</i>	<i>0-20 milion</i>

**2.3.3** Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë), Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licensën dhe listpagesat e shoqërisë, dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm

gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt dhe për të cilin duhet të paraqese dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Kontratë pune
- b) Diplomë

*(Ne rastin e Bashkimit të Operatoreve Ekonomik secili Operator duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varesi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë persiper sipas përqindjes së bashkepunimit.)*

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues për drejtuesin teknik, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe në UKM nr. 2 , datë 13.05.2005, Kreu I, pika 2. “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, i cili përcakton se Për projekte me vlerë të plotë të preventuar mbi 30,000,000 lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë të plotë në objekt i diplomuar në inxhinieri ndërtimi.Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.

**2.3.4** Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të cilët duhet të figurojnë në licencën si dhe listëpagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit, si mëposhtë:

- |                              |         |
|------------------------------|---------|
| - Inxhinier Ndërtimi         | 1 (një) |
| - Inxhinier Hidroteknik      | 1 (një) |
| - Inxhinier Elektrik         | 1 (një) |
| - Inxhinier Mekanik          | 1 (një) |
| - Inxhinier Gjeodet/Totograf | 1 (një) |

Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës noteriale e vlefshme dhe diploma.

Drejtuesit teknik duhet të jenë të punësuar sipas kriteve të VKM nr. 42 date 16.01.2008, i ndryshuar, sa i takon ndalimeve të dypunësimit. **Per kete arsye te paraqitet deklarate perkatese nga Administratori i shoqerise.**

Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues që OE i disponon punonjesit e mesiperem do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe në Vendimin e Keshillit të Ministrave nr.42 datë 16.01.2008



“Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi”, i ndryshuar me VKM nr. 92, date 19.02.2014 ku janë të percaktuar kategoritë përkatëse për licensat e subjekteve që ushtrojnë veprimtari në fushën e ndertimit. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

*Punimet apo veprimtaritë konkrete, të cilat lidhen edhe me kategoritë e licensave, për të cilat kërkohet ekspertiza e tyre profesionale:*

<i>1 (nje) Inxhinier Ndërtimi</i>	Eshtë përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar preventivit të punimeve ( <i>Punime ndertimi, Germimi, Prishje</i> ), të cilave i korrespondojnë kategoritë NP-1, NP-3, NP-4, NS-1, NS-4.
<i>1 (nje) Inxhinier Hidroteknik</i>	Eshtë përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve <i>Hidrosanitare, Kanalizime</i> , të cilave i korrespondon kategoria NP-7, NS-2.
<i>1 (nje) Inxhinier Elektrik</i>	Eshtë përgjegjës për punimet e rrjetit të brendshëm elektrik dhe telefonise si dhe punimet në ambientet e jashtme si: f.v të shtyllave të ndricimit, të cilave i korrespondon kategoria NP-11, NS-14.
<i>1 (nje) Inxhinier Mekanik</i>	Eshtë përgjegjës për ndjekjen e realizimit të punimeve të preventivit për instalimin e sistemit ngrohje ftohje, punime që përfshihen në kategorinë NS-12.
<i>1 (nje) Inxhinier Gjeodet</i>	Eshtë përgjegjës për zbatimin e saktë të kuotave të projektit punime që përfshihen në kategorinë NS-18

**2.3.5** Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik dhe punonjës të kualifikuar, si mëposhtë:

- 1 (nje) inxhinier mjedisi
- 1 (një) Inxhinier Elektronik/IT/Telekomunikacion
- 1 (një) arkitekt
- 1 (nje) punonjës teknik ndërtimi
- 1 (një) punonjës teknik topograf
- 3 (tre) elektriciste
- 2 (dy) hidraulike
- 2 (dy) karpentiere
- 2 (dy) hidroizolues
- 2 (dy) hekurkthyes
- 2 (dy) betonues
- 3 (tre) suvatues
- 3 (tre) bojaxhinj

- 2 (dy) muratore
  - 2 (dy) pllaka shtrues
  - 2 (dy) specialiste duro alumin
  - 1 (një) Mekanik
  - 1 (nje) saldator
  - 1 (nje) specialist instalues të sistemeve ngrohje-ftohje
  - 1 (një) specialist i çertifikuar për sistemet CCTV
  - 2 (dy) shofere
  - 2 (dy) manovratore eskavatoriste
  - 1 (nje) manovrator buldozerist
  - 2 (dy) manovratore automakiniste
  - 15 (pesëmbëdhjete) punonjës të thjeshtë/ndihmes
- Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit.
  - Per inxhinieret dhe arkitektin te paraqitet diploma perkatese e leshuar nga Institucione Arsimore te Arsimit te Larte te akredituara.
  - Per punonjesit e kualifikuar te ndertimit te paraqitet Çertifikatat/diplomat/deshmia te leshuara nga institucione publike/private te licencuara sipas ligjit nr.15/2017 “Per arsimin dhe formimin profesional ne R.SH “ I ndryshuar.
  - Për teknikun e ndërtimit dhe teknikun topograf do të pranohet vetem diploma e shkollës së mesme/licence profesionale nga institucionet përkatëse.
  - ***Nuk do të njihen si dëshmi profesionale kurset e trajnimit të lëshuara nga subjektet të cilat nuk janë të licensuara/akredituara nga institucionet përkatëse për licensimin/akreditimin e tyre.***
  - Ndersa per punonjesit shofere dhe manovratorë të mjeteve të rënda duhet të paraqiten deshmi te aftesise profesionale / leje drejtimi dhe certifikate e aftesimit profesional sipas rastit, të lëshuara nga D.P.SH.T Rrugore.
  - **Në rast se operatori ekonomik, i disponon mjetet e rënda në pronësi, duhet ti ketë operatorët e mjeteve në listëpagesë për tre muajt e fundit.**
  - **Për mjetet e rënda të cilat janë të marra me qera, OE duhet të paraqesë për manovratorin,** kontratën e punës së vlefshme, dëshminë e drejtimit të vlefshme, lëshuar nga institucionet përkatëse, dëshmitë e drejtimit të lëshuara nga D.P.SH.T Rrugore, por pa qenë e nevojshme që këta manovratorë të figurojnë në listëpagesën e OE.

Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues qe OE i disponon punonjesit e mesiperperm do të dorëzohet nga **ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.**

**Argumentimi:** vendosja e këtij kriteri bazohet në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për punonjesit e kualifikuar lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve, duke krijuar besueshmërinë se kane përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Në përcaktimin e profileve konkrete te stafit teknik punonjesve te kualifikuar,

si dhe numrit te tyre, AK eshte bazuar ne manualin e çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM Nr.629, date 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, VKM nr. 514, date 20.09.2017 “Per miratimin e listes kombetare te profesioneve (LKP), te rishikuar, Urdherin nr.200, date 16.05.2019 te Ministrit te Infrastruktures dhe Energjitikes “Për miratimin e rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit“, Ligjin Nr. 7961, datë 12.7.1995 “KODI I PUNËS I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË“, i ndryshuar, zerat e punimeve te preventivit, volumet per keto zera dhe të grafikut të punimeve.

- **Inxhinier mjedisi** eshte i nevojshem qe te jete prezent ne proceset e punes se parashikuara ne preventiv: Mbjellje bari ne skarpat gjithsej 1674 m<sup>2</sup>. Kerkesa eshte ne proporcion me natyren e punimeve dhe volumin e tyre.
- **1 (një) Inxhinier Elektronik/IT/Telekomunikacion** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve elektronike.
- **Arkitekti** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve sipas parashikimeve në projektin arkitektonik dhe zgjidhjet arkitektonike. Monitoron ndërtimin ose restaurimin në përputhje me specifikimet dhe standardet e cilësisë.
- **Tekniku i ndërtimit** është i nevojshem për ndjekjen e realizimit të punimeve të ndërtimit, sipas zërave të preventivit të punimeve, sic jane germimet, punimet e shtresave, punimet e betonit, punimet e muratures etj, lexon dhe kontrollon zbatimin e projektit ne perputhje me kushtet teknike te zbatimit (KTZ), implementon kerkesat dhe direktivat e inxhinierit dhe ndan detyrat per punetoret dhe ndjek ecurine e tyre gjate kohes se punes.
- **Tekniku topograf** është i nevojshem për ndjekjen e realizimit të punimeve të ndërtimit, për zbatimin e saktë të kuotave të projektit ne ndertimet e reja qe do te kryhen duke asistuar drejtuesin teknik.
- **Elektrici** është i nevojshem për realizimin e punimeve elektrike, sipas zërave të preventivit të punimeve. Numri i kerkuar eshte bazuar te grafiku i punimeve, ku punimet elektrike jane parashikuar te realizohen ne muajin e trete dhe te peste, si dhe tek perlllogaritjet e bera bazuar ne manualin e çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM Nr.216, date 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit te integruar per informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” per kohen e punes qe duhet per te realizuar cdo ze te punimeve te parashikuara ne preventiv. Keshtu sipas manualit oret e punes per te perfunduar punimet elektrike te parashikuara per tu realizuar ne muajin e trete jane rreth 1879 ore, qe te kthyer ne dite jane rreth 235 dite pune ( $1879/8=234.8$ ). Duke llogaritur qe keto punime duhet te perfundojne brenda 14 diteve del qe nr. i punonjesve duhet te jete rreth 17 persona. ( $235/14=16.7$ ). Pra jane llogaritur minimumi 3 punonjes te kualifikuar. Llogaritja e kohes ditore dhe javore te punes jane bere bazuar ne percaktimet e kodit te punes. (koha ditore e punes 8 ore dhe ajo javore 40 ore, gjithsej 22 dite pune ne muaj).
- **Hidrauliku** është i nevojshem për realizimin e punimeve hidraulike, sipas zërave të preventivit të punimeve. Numri i kerkuar eshte bazuar te grafiku i punimeve, ku punimet hidraulike jane parashikuar te realizohen ne muajin e trete, te peste dhe te gjashte, si dhe tek perlllogaritjet e bera bazuar ne manualin e çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM Nr.216, date 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit te integruar per informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” per kohen e punes qe duhet per te realizuar cdo ze te punimeve te

parashikuara ne preventiv. Keshtu sipas manualit oret e punes per te perfunduar punimet hidraulike te parashikuara per tu realizuar ne muajin e peste jane rreth 963 ore, qe te kthyer ne dite jane rreth 120 dite pune ( $963/8=120.3$ ). Duke llogaritur qe keto punime duhet te perfundojne brenda 10 diteve del qe nr. i punonjesve duhet te jete 12 persona. ( $120/10=12$ ). Pra jane llogaritur minimumi dy punonjes te kualifikuar hidraulike. Llogaritja e kohes ditore dhe javore te punes jane bere bazuar ne percaktimet e kodit te punes. (koha ditore e punes 8 ore dhe ajo javore 40 ore, gjithsej 22 dite pune ne muaj).

- **Specialist instalues** të sistemeve ngrohje-ftohje për realizimin e punimeve per instalimin e sistemit ngrohje-ftohje sipas zërave të preventivit.
- **Mekaniku** është i nevojshem për realizimin e punimeve mekanike per instalimin e sistemit ngrohje-ftohje sipas zërave të preventivit.
- **Saldatori** është i nevojshem për realizimin e punimeve te konstruksioneve metalike te thjeshta dhe te perbera sipas zërave të preventivit.
- **Karpentierët** janë të nevojshëm për punimet beton arme, punime themeli, kollona e soleta sipas zerave te preventivit. Bejne piketimin dhe armaturen anesore te themelit, bejne vendosjen e modinave per kolonat dhe muret e betonit, ndertojne armaturen, kallepet e kolonave, mureve, montojne skelerine perforcuese per fazen e betonimit te mureve dhe kolonave, prerjen dhe montimin e strukturave prej druri e metali si dhe ndertimin e kornizave dhe strukturave të tjera përforcuese prej druri, bashkimin dhe montimin e elementëve metalik apo materiale të tjera, të nevojshme për realizimin e objektit që do të ndërtohet. Numri i kerkuar eshte bazuar te grafiku i punimeve, ku te gjitha punimet ku kerkohet prezenca e punonjesve karpentiere eshte parashikuar te realizohet ne muajin e dyte dhe te trete, si dhe tek perlllogaritjet e bera bazuar ne manualin e çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM Nr.216, date 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit te integruar per informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” per kohen e punes qe duhet per te realizuar cdo ze te punimeve te parashikuara ne preventiv.
- **Hekurkthyesi** është i nevojshem për përzgjedhjen, prerjen, kthimin dhe vendosjen e hekurit, për realizimin zërave të punimeve te hekur betonit sipas preventivit. Numri i kerkuar eshte bazuar te grafiku i punimeve, ku te gjitha punimet ku kerkohet prezenca e punonjesve hekurkthyes eshte parashikuar te realizohet ne muajin e katert, si dhe tek perlllogaritjet e bera bazuar ne manualin e çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM Nr.216, date 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit te integruar per informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” per kohen e punes qe duhet per te realizuar cdo ze te punimeve te parashikuara ne preventiv. Sipas manualit oret e punes per te perfunduar punimet hekur betonit te parashikuara per tu realizuar ne muajin e katert jane rreth 778 ore, qe te kthyer ne dite jane rreth 97 dite pune ( $778/8=97.2$ ). Duke llogaritur qe keto punime sipas grafikut jane parashikuar te perfundojne ne 8 dite del qe nr. i punonjesve duhet te jete 12 persona. ( $97/8=12.1$ ). Pra jane llogaritur minimumi dy punonjes te kualifikuar. Llogaritja e kohes ditore dhe javore te punes jane bere bazuar ne percaktimet e kodit te punes. (koha ditore e punes 8 ore dhe ajo javore 40 ore, gjithsej 22 dite pune ne muaj).
- **Hidroizoluesit** janë të nevojshëm për punimet e hidroizolimit sipas zerave te preventivit. Numri i kerkuar eshte bazuar te grafiku i punimeve, ku punimet e hidroizolimit jane parashikuar te realizohen ne muajin e trete dhe te gjashte, si dhe tek perlllogaritjet e bera bazuar ne manualin e çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM Nr.216, date 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit te integruar per informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”

per kohen e punes qe duhet per te realizuar cdo ze te punimeve te parashikuara ne preventiv. Keshtu sipas manualit oret e punes per te perfunduar punimet e hidroizolimit te parashikuara per tu realizuar ne muajin e peste jane 981 ore, qe te kthyer ne dite jane rreth 123 dite pune ( $981/8=122.6$ ). Duke llogaritur qe keto punime sipas grafikut jane parashikuar te perfundojne ne 11 dite del qe nr. i punonjesve duhet te jete rreth 11 persona. ( $123/11=11.1$ ). Pra jane llogaritur minimumi 2 punonjes te kualifikuar. Llogaritja e kohes ditore dhe javore te punes jane bere bazuar ne percaktimet e kodit te punes. (koha ditore e punes 8 ore dhe ajo javore 40 ore, gjithsej 22 dite pune ne muaj).

- **Betonuesi** është i nevojshëm për realizimin e punimeve të betonit sipa zerave të preventivit. Ndhmon në ndërtimin e armaturës brenda së cilës do derdhet betoni, vendosin shtyllat mbajtëse të peshës, morsetat dhe mjetet e tjera që sigurojnë qëndrueshmërinë e armaturës ndaj peshës dhe presionit të ngarkesës beton, Shpërndajnë betonin dhe e shtrojnë atë në soleta, kolona, shkallë, mure, ballkone, ura, apo strukturave të tjera në kohën e duhur, sipas radhës së përcaktuar nga projekti dhe drejtuesi teknik i objektit, bëjnë vibrimin e betonit gjatë çdo betonimi, kryejnë nivelimin e betonit, kryejnë lustrimin e betonit apo çimentos. Numri i kerkuar është bazuar te grafiku i punimeve, ku te gjitha punimet ku kerkohet prezenca e punonjesve betonues është parashikuar te realizohet ne muajin e dyte, te trete dhe te peste, si dhe tek perlllogaritjet e bera bazuar ne manualin e çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM Nr.216, date 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit te integruar per informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” per kohen e punes qe duhet per te realizuar cdo ze te punimeve te parashikuara ne preventiv.
- **Pllaka shtruesi** është i nevojshëm për realizimin e punimeve të shtrimit të pllakave sipas zërave të preventivit të punimeve. Numri i kerkuar është bazuar te grafiku i punimeve, ku te gjitha punimet ku kerkohet prezenca e punonjesve pllaka shtrues është parashikuar te realizohet ne muajin e trete, te katert dhe te gjashte, si dhe tek perlllogaritjet e bera bazuar ne manualin e çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM Nr.216, date 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit te integruar per informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” per kohen e punes qe duhet per te realizuar cdo ze te punimeve te parashikuara ne preventiv. Duke qene se prezenca me e madhe kerkohet ne muajin e katert atehere, duke ju referuar menyres se perlllogaritjes se mesipercituar rezulton se sipas manualit oret e punes per te perfunduar punimet ku kerkohet prezenca e pllakashtruesit te parashikuara per tu realizuar ne muajin e peste jane rreth 2117 ore, qe te kthyer ne dite jane rreth 265 dite pune ( $2117/8=264.6$ ). Duke llogaritur qe sipas grafikut jane parashikuar te perfundojne ne 22 dite del qe nr. i punonjesve duhet te jete 12 persona. ( $265/22=12$ ). Pra jane llogaritur minimumi 2 punonjes te kualifikuar. Llogaritja e kohes ditore dhe javore te punes jane bere bazuar ne percaktimet e kodit te punes. (koha ditore e punes 8 ore dhe ajo javore 40 ore, gjithsej 22 dite pune ne muaj).
- **Suvatuesi** është i nevojshëm për realizimin e punimeve të suvatimit sipas zërave të preventivit. Kryejen vendosjen e një ose më shumë shtresave të suvasë në muret e brendshme dhe në tavanet e godinave duke realizuar një sipërfaqe të lëmuar. Numri i kerkuar është bazuar te grafiku i punimeve, ku te gjitha punimet ku kerkohet prezenca e punonjesve suvatues është parashikuar te realizohet ne muajin e trete, si dhe tek perlllogaritjet e bera bazuar ne manualin e çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM Nr.216, date 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit te integruar per informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” per kohen e

punes qe duhet per te realizuar cdo ze te punimeve te parashikuara ne preventiv. Keshtu sipas manualit oret e punes per te perfunduar punimet e suvatimit te parashikuara per tu realizuar ne muajin e trete jane rreth 4834 ore, qe te kthyer ne dite jane rreth 604 dite pune ( $4834/8=604.25$ ). Duke llogaritur qe sipas grafikut jane parashikuar te perfundojne ne 22 dite del qe nr. i punonjesve duhet te jete rreth 27 persona. ( $604/22=27.4$ ). Pra jane llogaritur minimumi 3 punonjes te kualifikuar. Llogaritja e kohes ditore dhe javore te punes jane bere bazuar ne percaktimet e kodit te punes. (koha ditore e punes 8 ore dhe ajo javore 40 ore, gjithsej 22 dite pune ne muaj).

- **Muratori** është i nevojshëm për realizimin e punimeve të muraturës, soletave etj. sipas zërave të preventivit. Bëjnë piketimin e mureve të objektit, bëjnë përgatitjen e sasisë së nevojshme të llacit për procesin ditor të punës, bëjnë breza përforcues betoni në gjysmën e lartësisë së murit ose sipas specifikimit në projekt; kontrollojnë nëse muret janë të lidhur midis tyre horizontalisht dhe vertikalisht duke garantuar kështu qëndrueshmërinë e tyre, ndërtojnë soletat, vendosin arkitrarët e dyerve dhe dritareve, bëjnë mbushjen me llac të mureve në nivelin e fashove me dorë ose me pompë në varësi të materialit të përcaktuar nga drejtuesi teknik në objekt, përgatitin materialin e nevojshëm për tavane me gips apo për tavane të varura zbukurues duke bërë matjet dhe prerjet e dhura. Numri i kerkuar është bazuar te grafiku i punimeve, ku punimet kryesore ku kerkohet prezenca e punonjesve muratore është parashikuar te realizohet ne muajin e dyte dhe te trete, si dhe tek perlllogaritjet e bera bazuar ne manualin e çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM Nr.216, date 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit te integruar per informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” per kohen e punes qe duhet per te realizuar cdo ze te punimeve te parashikuara ne preventiv. Keshtu sipas manualit oret e punes per te perfunduar vetem punimet murature tulle te parashikuara per tu realizuar ne muajin e dyte jane 631 ore, qe te kthyer ne dite jane rreth 79 dite pune ( $631/8=78.8$ ). Duke llogaritur qe sipas grafikut jane parashikuar te perfundojne ne 7 dite del qe nr. i punonjesve duhet te jete rreth 11 persona. ( $79/7=11.2$ ). Pra jane llogaritur minimumi dy punonjes te kualifikuar. Llogaritja e kohes ditore dhe javore te punes jane bere bazuar ne percaktimet e kodit te punes. (koha ditore e punes 8 ore dhe ajo javore 40 ore, gjithsej 22 dite pune ne muaj).
- **Bojaxhiu** është i nevojshëm për realizimin e punimeve të lyerjes me boje sipas zërave të preventivit të punimeve. Kryen përgatitjen e sipërfaqeve të ndërtesave dhe strukturave të tjera për lyerje, kryen përgatitjen e materialeve që do të përdoren për lyerje, bejne stukime, zmerilime, pastrime, kryejnë lyerjen me astar të sipërfaqes për lidhjen e saj me bojën, kryejnë lyerjen përfundimtare të sipërfaqeve me ngjyrat e përgatitura, bëjnë lyerjen me materiale përkatëse dhe bojëra mbrojtëse të sipërfaqeve të drunjtja, të strukturave metalike, kornizave të hekurta të ndërtesave. Numri i kerkuar është bazuar te grafiku i punimeve, ku te gjitha punimet ku kerkohet prezenca e punonjesve bojaxhinj është parashikuar te realizohet ne muajin e gjashte, si dhe tek perlllogaritjet e bera bazuar ne manualin e çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM Nr.216, date 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit te integruar per informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” per kohen e punes qe duhet per te realizuar cdo ze te punimeve te parashikuara ne preventiv. Keshtu sipas manualit oret e punes per te perfunduar punimet e lyerjes me boje jane rreth 1790 ore, qe te kthyer ne dite jane rreth 224 dite pune ( $1790/8=223.7$ ). Duke llogaritur qe sipas grafikut jane parashikuar te perfundojne ne 22 dite del qe nr. i punonjesve duhet te jete rreth 10 persona. ( $224/22=10.1$ ). Pra jane llogaritur minimumi 3 punonjes te kualifikuar bojaxhinj. Llogaritja e kohes ditore dhe javore te punes jane bere bazuar

ne percaktimet e kodit te punes. (koha ditore e punes 8 ore dhe ajo javore 40 ore, gjithsej 22 dite pune ne muaj).

- **Specialist duro alumini** është i nevojshëm për realizimin e punimeve të vendosjes së dyerve dhe dritareve d/alumini sipas zërave të preventivit të punimeve. Kryejnë matje në objektin ku do të bëjnë punime duro-alumini; Presin dhe përgatitin objekte (dyer, dritare etj.) për porosinë e marrë duke u mbështetur në përmasat e kasë; Presin dhe vendosin xhama në dritaret e gominave; Kryejnë punime të ndryshme të duro-aluminit në ndërtesa. Numri i kerkuar është bazuar në grafikun e punimeve, ku të gjitha punimet ku kërkohej prezenca e punonjesve bojxhinj është parashikuar të realizohet në muajin e gjashtë, si dhe tek përlogaritjet e bera bazuar në manualin e çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM Nr.216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” për kohën e punës që duhet për të realizuar çdo zë të punimeve të parashikuara në preventiv. Kështu sipas manualit orët e punës për të përfunduar punimet e f.v dyer dhe dritare d/alumini janë rreth 710 ore, që të kthyer në ditë janë rreth 89 ditë pune ( $710/8=88.7$ ). Duke llogaritur që sipas grafikut janë parashikuar të përfundojnë në 8 ditë del që nr. i punonjesve duhet të jetë rreth 11 persona. ( $89/8=11.1$ ). Pra janë llogaritur minimumi 2 punonjes të kualifikuar. Llogaritja e kohës ditore dhe javore të punës janë bërë bazuar në percaktimet e kodit të punës. (koha ditore e punës 8 ore dhe ajo javore 40 ore, gjithsej 22 ditë pune në muaj).
- **Specialist i certifikuar për sistemet CCTV** lidhet drejtpërdrejtë me zërat e preventivit si: F.V. NVR-(Network Video Recorder) 16- kanale, (Programim, testim dhe komisionim i sistemit të vëzhgimit CCTV), instalimi dhe konfigurimi i të cilave kërkon specialist të certifikuar për këtë qëllim.
- **Shoferi** është i nevojshëm për drejtimin e mjeteve si kamione, kamionçina. Numri i kerkuar është bazuar në numrin e mjeteve që duhen, volumet për transportin e dherave dhe materialeve të ndërtimit të dalë nga gërmimi dhe prishja, transportin e materialeve që do të përdoren për realizimin e objektit. Kështu sipas grafikut është parashikuar që vetëm për transportin e materialeve të ndërtimit dhe dherave, që duhet të përfundojë brenda 22 ditëve dhe sipas vëllimeve janë llogaritur 2 mjete me tonazh min 12 ton.
- **Manovratori eskavatorist** është i nevojshëm për përdorimin e makinerive të rënda të ndërtimit si eskavator gërmimi dhe fadroma të të gjitha llojeve, të cilat janë kerkuar pasi në preventiv janë parashikuar punime që kërkojnë përdorimin e këtyre makinerive. Në nenin 8, germa a, të rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjitikës përcaktohet: Makineritë e rënda të ndërtimit dhe emërtimet bëhen sipas Dëshmisë të Aftësisë Profesionale (DAP), të cilat ndahen si më poshtë:  
a)-eskavator gërmimi e ngarkimi dherash të të gjitha llojeve si dhe fadromat e të gjitha llojeve (me goma dhe me zinxhirë), manovratorëve u jepet dëshmi për **ESKAVATORIST**.
- **Manovratori buldozerist** është i nevojshëm për përdorimin e makinerive të rënda të ndërtimit si grejder, **rrul vibrues**, të cilat janë kerkuar pasi në preventiv janë parashikuar punime që kërkojnë përdorimin e këtyre makinerive. Në nenin 8, germa b, të rregullores “Për kushtet, kriteret dhe

programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtim dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjistikës percaktohet: Makineritë e rënda të ndërtimit dhe emërtimet bëhen sipas Dëshmive të Aftësive Profesionale (DAP), të cilat ndahen si më poshtë:

b)- buldozer gjermimi, shtyrje, nivelimi e ngjeshje dherash apo shpim toke: të gjithë llojet e traktorëve me thikë (ruspë), ose që tërheqin skreper, grejder apo nivelues, **rul vibrues**, shtruese asfalto-betoni, skreperët, **grejderët dhe niveluesit kur janë vetëlëvizës**, të gjithë llojet e traktorëve, me pajisje shtesë për ngritjen e peshave, shpimin e puseve etj. **manovratorëve u jepet dëshmi për BULDOZERIST.**

- **Manovratori automakinist** është i nevojshëm për përdorimin e makinerive të rënda të ndërtimit si autobetoniere, autovinca, autopompe betoni, të cilat janë kërkuar pasi në preventiv janë parashikuar punime që kërkojnë përdorimin e këtyre makinerive. Në nenin 8, germa c, të rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtim dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjistikës percaktohet: Makineritë e rënda të ndërtimit dhe emërtimet bëhen sipas Dëshmive të Aftësive Profesionale (DAP), të cilat ndahen si më poshtë:

c)-Automjete për përdorim të veçantë (APV) sipas pikës “g”, të nenit 54, të Kodit Rrugor, makineri ndërtimi mbi bazë automjeti:-**autovinça, autobetonierë, autopompa betoni**, autobitumatriçe, autosonda, autotokmak, manovratorëve u jepet dëshmi për **AUTOMAKINIST.**

**2.3.6** Nje punësim mesatar **per tre muajt e fundit**, i të paktën **60** (gjashtedhete) personave të vërtetuar me :

- a) Vërtetim të lëshuar nga autoritetet përkatëse, në mënyrë elektronike, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj;
- b) Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e kërkuar.

Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit.

Dokumentacioni provues që OE i disponon punonjesit e mesipërdo të dorëzohet nga **ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.**

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Autoriteti kontraktor në përcaktimin fuqisë punëtore të nevojshme për realizimin e kontratës është bazuar në llogaritjen e orëve të punës sipas manualit të çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM Nr.216, date 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”, Ligjin Nr. 7961, datë 12.7.1995 “KODI I PUNËS I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË“, i ndryshuar, grafikun e punime, zërat e punimeve të preventivit, volumet për keto zëra. **Duke e bazuar në keto komponente AK percaktoi**



**stafin kryesor teknik (inxhinieret), nje numer minimal punonjesish te kualifikur per cdo lloj punimesh dhe nje numer minimal punonjesish te thejshite/ndihmes. Nga ky numer rezultoi se per te perfunduar brenda afatit dhe me sukses zbatimin e kontrates operoret ekonomike pjese-marres duhet te kene minimalisht nje numer prej 60 punonjesish (stafi kryesor teknik + punonjes te kualifikur + punonjes te thejshite/ndihmes).**

**2.3.7** Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij punonjes te certifikuar si me poshte:

- 2 (dy) punonjës të certifikuar për “*Punime në lartësi*”, sipas VKM-së Nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”, e dhënë nga një organizem i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj.
- 1 (një) punonjes i pajisur me certifikate “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”, (I ndryshuar).

Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit.

- 1 (nje) punonjes i pajisur me certifikate “Ekspert Zjarrefikes”, lëshuar nga MZSH. Disponimi i këtij punonjësi mund të sigurohet nëpërmjet kontrates se punës, e cila duhet të jete e vlefshme gjate gjithë kohezgjatjes se ekzekutimit te kontrates, si dhe te figuroje ne listepagesat e shoqërisë minimumi per periudhen e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues qe OE i disponon punonjesit e mesipërmdo të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

**Argumentimi:** Këto kritere jane vendosur bauer në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, te Ligjit 10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” si dhe të VKM Nr.312, date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”, ligjit nr.152/2015 “Per sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin, neni 49, pika 4. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Njësia e prokurimit gjykon se për mbarëvajtjen e punimeve, me qëllim garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen e shëndetit, nëpërmjet parandalimit të rreziqeve profesionale, eliminimit të faktorëve që përbëjnë rrezik dhe aksident si dhe në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni sektorial në fuqi, është e nevojshme prezenca e ekspertit per sigurine dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në kantierin e punimeve si dhe punonjesve te kualifikuar per punimet ne lartesi. Në nenin 6 të ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë, i ndryshuar parashikohet:

”Detyrime të përgjithshme të punëdhënësve

1. Punëdhënësi, për sigurimin e mbrojtjes së punëmarrësve në të gjitha aspektet, që lidhen me sigurinë dhe shëndetin në punë, merr masat e nevojshme nëpërmjet:

- a) parandalimit të rreziqeve për aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale;
- b) informimit dhe formimit profesional të punëmarrësve e të përfaqësuesve të tyre;
- c) organizimit të mbrojtjes kolektive dhe individuale;
- ç) sigurimit të organizimit të vendit të punës e të mjeteve të nevojshme.

2. Punëdhënësi kujdeset për përditësimin e masave të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, duke marrë parasysh ndryshimet e rrethanave, për përmirësimin e situatave ekzistuese.

Ne nenin 7 Shërbimet e mbrojtjes dhe të parandalimit, parashikohet:

1. Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarrës, që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë dhe të parandalimit të rreziqeve profesionale në ndërmarrje/institucion.

Në pikën 15 të V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”, ndër të tjera parashikohet:

#### 15.1 Përkufizime

Në aplikimin e këtyre rregullave, kërkesave, me termat e mëposhtëm kuptojmë:

- a) pajisje pune është çdo makinë, aparat, instalim që përdoret në punë;
- b) përdorim i një pajisje pune: çdo operacion pune i lidhur me një pajisje pune në përdorim ose jo, transporti, riparimi, transformimi, mirëmbajtja, pastrimi, çmontimi;
- c) zonë e rrezikshme: çdo zonë brenda ose në afërsi të një pajisje pune, në të cilën prania e një punëmarrësi përbën rrezik për shëndetin ose sigurinë e tij.
- ç) **puna në lartësi: aktivitet pune e cila ekspozon punëmarrësin ndaj rrezikut të rënies nga një lartësi më e madhe se 2 metra, referuar një niveli të palëvizshëm.**

**Eksperti zjarrfikës është i domosdoshëm të jetë prezent në fazën e realizimit të projektit të zbatimit të mbrojtjes ndaj zjarrit dhe vlerësimeve përkatëse të fushës.**

#### 2.3.8 Operatori ekonomik duhet të paraqesë :

Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikata të vlefshme:

- SSH/EN-ISO 9001 (*Sistemi i menaxhimit të cilësisë*) ose ekuivalent
- SSH/EN-ISO 14001 (*Sistemi i menaxhimit të mjedisit*) ose ekuivalent
- SSH/EN-ISO 45001 (*Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë*) ose ekuivalent
- SSH/EN-ISO 50001 (*Sistemi i menaxhimit të energjisë*) ose ekuivalent

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, cdo anëtar i këtij bashkimi duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt-marrëveshjes).

**Argumentimi:** Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sa më sipër janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 dhe 2 ku citohet se: 1. “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”; 2. Autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë ofertuesve dorëzimin e certifikatave ose dokumenteve të ngjashme, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, veçanërisht sa i takon:

a) garantimit të aksesit të personave me aftësi të kufizuara;

**b) efikasitetit të energjisë;**

**c) sistemeve të menaxhimit mjedisor,**

si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

ISO 9001 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t'i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001 është standard ndërkombëtare, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

ISO 50001 Objektivi kryesor i standardit është të përmirësojë vazhdimisht performancën e lidhur me energjinë dhe eficientësinë e energjisë dhe të identifikojë mundësitë e reduktimit të energjisë.

Eshtë një standard për projektimin, zbatimin dhe mirëmbajtjen e një sistemi të menaxhimit të energjisë. ISO 50001 ofron një kornizë më specifike që u mundëson organizatave të aplikojnë një fokus më të mprehtë për efikasitetin e energjisë. Mbështet organizatat në të gjithë sektorët që të përdorin energjinë në mënyrë më efikase përmes zhvillimit të një Sistemi të Menaxhimit të Energjisë. Standardi specifikon kërkesat për krijimin, zbatimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e një sistemi të menaxhimit të energjisë, qëllimi i të cilit është t'i mundësojë një organizatë të ndjekë një qasje sistematike në arritjen e përmirësimit të vazhdueshëm të performancës së energjisë, duke përfshirë eficientësinë e energjisë, sigurinë e energjisë, përdorimin e energjisë, dhe konsumin. Kërkesa është vendosur në perputhje me Vendimin Nr. 537, datë 8.7.2020 "Për miratimin e kërkesave minimale të performancës së energjisë së ndërtesave dhe të elementëve të ndërtesave". Duhet që godina në përfundim të pajiset me certifikatën përfundimtare të performancës së energjisë, për këtë arsye do të duhet një monitorimin hap pas hapi të gjithë elementeve të godinës dhe shtresave /mbështjellsave të saj, në mënyrë që të përmbushë qëllimin dhe godina të plotësojë klasifikimin minimal energjetik.

**2.3.9** Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesë dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion të cilat janë si më poshtë vijon:

Nr	Lloji i makinerive/pajisjeve/mjeteve	Pronësia	Njësia	Sasia
1	Automjet vetshkarkues me kapacitet mbajtes minimumi 12 ton	Pronësi/Qira	copë	2
2	Automjet vetshkarkues me kapacitet mbajtes 3.5 - 12 ton	Pronësi/Qira	copë	1
3	Kamioncine me kapacitet mbajtes deri 3.5 ton	Pronësi/Qira	cope	2

4	Eskavator me goma	Pronësi/Qira	copë	1
5	Fadrome me goma	Pronësi/Qira	copë	1
6	Autobetoniere	Pronësi/Qira	copë	2
7	Autopompe Betoni	Pronësi/Qira	copë	1
8	Autobot uji	Pronësi/Qira	copë	1
9	Rrul vibrues	Pronësi/Qira	copë	1
10	Grejder	Pronësi/Qira	copë	1
11	Vinc kulle	Pronësi/Qira	copë	1
12	Autovinc	Pronësi/Qira	copë	1
13	Minidumper	Pronësi/Qira	copë	1
14	Pompë suvatimi	Pronësi/Qira	copë	2
15	Nivelues Helikopter	Pronësi/Qira	copë	1
16	Badibald/Kompaktor	Pronësi/Qira	copë	1
17	Gjenerator	Pronësi/Qira	copë	1
18	Vibrator thellesie	Pronësi/Qira	copë	2
19	Automjet me kosh	Pronësi/Qira	copë	1
20	Skeleri	Pronësi/Qira	m <sup>2</sup>	Min 600
21	Betoniere	Pronësi/Qira	copë	3
22	Elevator per ngritje llaç/çimento	Pronësi/Qira	copë	1
23	Elektro saldatriçe	Pronësi/Qira	copë	1
24	Tranxh Hekuri	Pronësi/Qira	copë	1

25	Fabrike betoni	Pronësi/Qira/Kontrate furnizimi	cope	1
----	----------------	---------------------------------	------	---

a) Për mjetet që regjistrohen ne regjistra publike duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, Çertifikaten e pronesise, Çertifikatë për transport mallrash për llogari të vetë (vetem mjetet e transportit) dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe për mjetet e siguruara me qera, dokumentet e mesiperme duhet të shoqerohen me kontratën noteriale perkatese të qerave, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Për mjetet e transportit me qera të paraqitet gjithashtu Çertifikatë për transport mallrash për të trete dhe me qira. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të paraqiten aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

b) Për fabriken e betonit dhe dhe fabriken e prodhimit të elementeve të betonit - bordurave dhe pllakave, duhet të paraqesin dokumentacionin e pronesise/kontraten e qirase/kontraten e furnizimit. Në rast se fabrika është në pronësi/qira duhet të paraqitet edhe leja mjedisore leshuar nga QKL Kodi III.1.B. Në rast se do të paraqitet kontrate furnizimi OE nuk detyrohet të paraqesë lejen mjedisore leshuar nga QKL Kodi III.1.B.

Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit.

Dokumentacioni provues, që OE i disponon mjetet e mësipërme, do të dorëzohet nga operatori **ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.**

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç, 6/d dhe 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Gjithashtu kriteri është vendosur referuar zerave të punimeve.

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës bazuar në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018).

Në mbështetje të dispozitës ligjore të sipërcituar Ligjvënësi i jep të drejtën Autoritetit Kontraktor të kërkojë nga ana e Operatorëve ekonomike **makinerite, mjetet dhe pajisjet teknike.** Njësia e Prokurimit ka vlerësuar si të domosdoshëm paraqitjen e deklaratave dhe dokumentacionit përkatës në lidhje me mjetet dhe pajisjet teknike që Operatori ekonomik disponon në funksion të realizimit të kontratës objekt prokurimi.

Percaktimi i makinerive është bërë referuar zërave të punimeve reflektuar në tabelë sa më poshtë:

Nr	Lloji i Makinerive	Proceset sipas preventivit	Sasia
----	--------------------	----------------------------	-------

1	Eskavator me goma	Germim dhe themele e plinta me b-2m, ekskavator me goma 0.25m <sup>3</sup> ,shkarkimi ne toke; Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m <sup>3</sup> , ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet	copë 1
2	Fadrome me goma	Eshte kerkuar per shtytjen dhe largimin e mbeturinave qe krijohen nga germimet apo prishjet, sistemimin e ambjentit.	copë 1
3	Automjet veteshkarkues me kapacitet mbajtes minimumi 12 ton (Sipas grafikut eshte parashikuar qe vetem transporti i materialeve te ndertimit dhe dherave duhet te perfundoje brenda 2 muajve ose 44 dite. Vetem ne muajin e dyte kemi nje volum prej 716 m <sup>3</sup> dhera dhe materiale ndertimi jane llogaritur dy mjete me tonazh min 12 ton per te realizuar transportin brenda afatit sipas grafikut)	Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 5.0 km	copë 2
4	Automjet veteshkarkues me kapacitet mbajtes 3.5 - 12 ton. Eshte kerkuar nje mjet me kapacitet te tille pasi gjate zbatimit te kontrates hapësirat per shkak te mjeteve apo pajisjeve qe do te jene te instaluar ne kantier, punonjesve, materialeve etj, do te jene te kufizuara.	Transport materialesh voluminoze gjate gjithë kohes se zbatimit te kontrates	cope 1
5	Kamionçine me kapacitet mbajtes deri ne 3.5 ton	Per transoportin ne kantier te materialeve te punes gjate gjithë kohes se zbatimit te kontrates.	copë 2
6	Autobetoniere (AK ka vendosur te kerkoje minimalisht 2 mjete te tille per te garantuar zbatimin me sukses te kontrates duke pasur parasysh natyren e procesit te punes, sasine e prodhimit te nje auto betoniere, grafikun dhe volumin sipas preventivit.	Prodhim dhe transport betoni sipas proceseve dhe markave te ndryshme pjese e preventivit	copë 2

7	Rul vibrues	Cilindrim kasonete me rul; Shtrese çakelli mbeturine kave t=15cm, perhapur e ngjeshur me makineri; Shtrese zhavori lumi t=10cm, perhapur e ngjeshur me makineri; Shtrese zhavori lumi t=10cm, perhapur e ngjeshur me makineri; Shtrese zhavori lumi t=10cm, perhapur e ngjeshur me makineri	copë 1
8	Automjet me kosh	Hidroizolim taracash, ngjitje punonjesish dhe materialesh, punime ullqesh, F.V Ndricues; etj sipas zerave te preventivit	copë 1
9	Autopompe betoni	Hedhja e betonit sipas proceseve te punes te parashikuara ne preventive: Breza b/a monolit C 16/20; Trare e arkitrare b/a C20/25 h ~ 4m etj	copë 1
10	Pompe suvatimi (AK ka vendosur te kerkoje minimalisht 2 pajisje te tilla per te garantuar zbatimin me sukses te kontrates. Numri eshte ne proporcion me volumin e punimeve te parashikuara ne preventive dhe grafikun e punimeve)	Hedhje dhe sprucim llaci per punimet e suvatimit sipas preventivit	copë 2
11	Grejder	Shtrese çakelli mbeturine kave t=15cm, perhapur e ngjeshur me makineri; Shtrese zhavori lumi t=10cm, perhapur e ngjeshur me makineri; Shtrese zhavori lumi t=10cm, perhapur e ngjeshur me makineri; Shtrese zhavori lumi t=10cm, perhapur e ngjeshur me makineri	
12	Autovinç	Ngritje dhe vendosje ne veper materialesh ne lartesi, te cilat kane peshe te kosiderueshme si polisterol, katrama, tulla, konstruksione metalike, rezervuar etj.	copë 1
13	Autobot uji	Per furnizimin me uje te kantierit per procese te ndryshme gjate punes	copë 1
14	Vibrator thellesie (AK ka vendosur te kerkoje minimalisht 2 mjete te tille duke pasur parasysh volumin e konsiderueshem te punimeve te betonit. )	Vibrim betoni sipas proceseve dhe markave te ndryshme pjese e preventivit: Struktura monolite betoni C 16/20; Struktura monolite betoni C 12/15	cope 2
15	Minidumper	Per levizjen e materialeve brenda kantierit. Duke qene se hapesirat jane te kufizuara eshte kerkuar minidumper	cope 1
16	Nivelues Helikopter	Shtrese lluster cemento 1:2 t = 20 mm	cope1
17	Vinç kulle	Per punimet e ndryshme, transport materialesh, ne lartesi ne ambientet e jashtme sipas preventivit,	cope 1
18	Gjenerator	Furnizimin me energji te pajisjeve te ndryshme gjate proceseve te punes	copë 1

19	Skeleri (Sasia eshte kerkuar duke pasur parasysh siperfaqen e godines)	Per punimet e ndryshme ne ambientet e jashteme si suvatime, veshje me polisterol, lyerje me boje.	600 m2
20	Betoniere	Per prodhim llaçi per suvatim	cope 3
21	Badibald/Kompaktor	Per ngjeshjen e pllakave te trotuarit Trotuar, me 6 cm beton, me pllaka	cope 1
22	Elektro saldatriçe	Per punimet e saldimit: F V konstruksione metalike te perbera; F V konstruksione metalike te thjeshta	cope 1
23	Tranxh hekuri	Per prerjen dhe kthimin e hekurit F V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm F V hekur betoni periodik Ø > 12 mm	cope 1
24	Elevator per ngritje llaç/çimento	Per punimet sipas preventivit per ngritje llaçi, çimentoje	cope1
25	Fabrike betoni. Kerkesa eshte ne propocion me volumin e kontrates. Punimet e betonit jane nje nga zerat me te rendesishem te punimeve, si edhe duke qene nje nga zerat me sasine dhe vleren me te madhe financiare.	Per furnizim me beton sipas preventivit.	cope 1

**2.3.10** Per materialet/produktet: hekur, boje hidroplastike, materiale hidroizolimi (katrama), polisterol, tapet tartani, dyer dhe dritare d/alumini, pajisje ngrohje (kaldaje me lende djegese pellet dhe radiator), në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontrate noteriale furnizimi me prodhuesin/t ose distributorin/ët zyrtare te tyre per furnizimin me materialet e mesiperme gjate zbatimit te kontrates, Katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit/ve, ku të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të perdoren dhe të jenë paraqitur dhe markuar të dhënat teknike për mallrat objekt prokurimi. Ne rastin e kontrates me distributorin te dokumentohet lidhja e tij me prodhuesin.

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”: Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. Vendosija e këtij kriteri, referuar edhe legjisllacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar se operatori ekonomik do te siguroje produktet e kërkuara ne perputhje me specifikimet teknike. Kerkesa per keto produkte eshte ne proporcion me rendesine, sasine dhe vleren financiare qe keto produkte zene ne preventiv.



### **Argumentimi i specifikimeve teknike**

Specifikimet Teknike per proceduren respektive jane hartuar nga drejtoria e projekteve, pjese perberese e struktures se Bashkise Elbasan, qe ka hartuar edhe projektin perkates te zbatimit duke qene elemente perberes te tij. Ne hartimin e tyre jane marre ne konsiderat kerkesat ligjore te fushes se planifikimit dhe zhvillimit te territorit si dhe normat perkatese te Ligjit nr. 9290 , date 7.10.2004 “Për produktet e ndërtimit” i ndryshuar dhe Vendim i KM nr.312, datë 5.5.2010 Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” si dhe kerkesat e ligjit te Ligjit Nr. 10480 datë 17.11.2011 , "Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore".

Specifikimet Teknike jane pjese e setit te dokumentave te ngarkuara ne SPE per proceduren respektive.

**Fondi Limit i perllogaritur per kete procedure eshte hartuar ne baze te VKM nr 629 date 15.07.2015 ''Per Miratimin e Manualeve Teknike te Cmimeve te Ndertimit dhe analizat teknike te tyre''**,

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*